



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 09.07.2019
Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
SHËRVIMITT Ë PROVËS”

- ***Hyrje***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi në mbledhjen e datës 09.07.2019 në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “*Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës*”.

Për të prezantuar projektligjin në komision ishin të pranishëm Zëvendësministrja e Ministrisë së Drejtësisë Znj.Fjoralba Caka, Z.Edis Ibrahimi, këshilltar i Ministrit të Drejtësisë dhe Z.Edmond Duro, Drejtor i Zyrës Vendore, Tiranë.

Relator i projektligjit u caktua deputeti Xhemal Qefalia.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Përgatitja e projektligjit është bazuar në nenet 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Problematikat e konstatuara gjatë zhvillimit të veprimtarisë së Shërbimit të Proves në ekzekutimin e dënimeve alternative në vendin tonë, qoftë në aspektin teorik apo praktik, si dhe ndryshimet që ka pësuar legjislacioni penal, kanë diktuar nevojën e ndërhyrjes shtetërore me qëllim reformimin dhe rikonceptimin në tërësi të këtij institucioni .

Projektligji ka për qëllimi plotësimin e mangësive të konstatuara në vendimin nr.302, datë 25.3.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për organizimin e funksionimit të Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”, ekzistues, dhe të cilësuar si të nevojshme për realizimin e një procesi të rregullt ligjor.

Ky projektligji synon të rregullojë organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës, si dhe përcakton procedura për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe ekzekutimin e dënimeve alternative, trajtimin e individualizuar të nevojave dhe aftësive të personit të mbikëqyrur për riintegrimin e tij në jetën shoqërore.

Objektivat e projektligjit janë:

- Reduktimi i recidivizmit dhe garantimi i promovimit dhe integritetit social të personave të mbikëqyrur në shoqëri.
- Rritja e sigurisë në komunitet, duke ulur rrezikshmërisë e shkakut të dëmit ndaj publikut të gjerë.
- Administrimi i drejtë i drejtësisë.
- Harmonizimi dhe unifikimi me parashikimet ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. (ligji nr. 37/2017)
- Reduktimi i kostove sociale të dënimeve penale.
- Rritja e partneritetit dhe bashkëpunimit me organizata të tjera publike ose private dhe me komunitetet vendore për të promovuar përfshirjen sociale të dënuarve/personave në shërbim prove.
- Forcimi i mbikëqyrjes së ekzekutimit të masave dhe ekzekutimit të dënimeve alternative.
- Trajtimi i individualizuar i nevojave dhe aftësive të personit të mbikëqyrur për ri-integrimin e tyre në jetën shoqërore.
- Përcaktimi i qartë dhe konkret i detyrimeve për punonjësit e institucionit të Shërbimit të Provës, në përputhje me standardet që përcaktohen në Rekomandimet e Këshillit të Evropës.
- Rritja e numrit të dhënies së dënimeve alternative nga gjykata dhe shmangies nga burgimi.

Për vetë rëndësinë që paraqet në fushën e ekzekutimit të dënimeve alternative në fushën penale dhe shtrirjes së madhe që ka ky institucion, nëpërmjet rregullimit të tij me ligj synohet të forcohet më shumë pozita e këtij institucioni dhe kompetencat e tij në sistemin penitenciar, duke u përpjekur për të krijuar një qëndrueshmëri më të madhe ligjore dhe institucionale sipas standardeve ndërkombëtare.

• Diskutimi në komision

Zëvendësministrja Znj.Fjoralba Caka, në fjalën e saj u shpreh se nisma për rregullimin me ligj të shërbimit të provës është një nevojë që ka lindur për të konsoliduar

dhe dhënë më shumë siguri një shërbimi që tashmë është pjesë përbërëse e sistemit penitenciar.

Aktualisht, shërbimi i provës ka zhvilluar veprimtarinë e tij bazuar në vkm-në nr.302, datë 25.3.2009 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standarteve e të procedurave për mbikqyrjen e ekzekutimi të dënimeve alternative””.

Znj.Caka u shpreh se nevoja për të rregulluar me ligj këtë institucion është përcaktuar në Rekomandimin CM/Rec (1992) 16 dhe CM/Rec (2010) 1 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës me qëllim rritjen e sigurisë juridike të subjekteve që trajtohen dhe asistohen nga shërbimi i provës ashtu edhe të punonjësve të vetë shërbimit.

Gjithashtu, problematikat e konstatuara gjatë zhvillimit të veprimtarisë së Shërbimit të Provës në ekzekutimin e dënimeve alternative në vendin tonë, qoftë në aspektin teorik apo praktik, si dhe ndryshimet që ka pësuar legjislacioni penal, kanë diktuar nevojën e ndërhyrjes shtetërore me qëllim reformimin dhe rikonceptimin në tërësi të këtij institucioni .

Mandej, ajo theksoi se projektligji synon të rregullojë organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës, si dhe përcakton procedura për mbikqyrjen e ekzekutimit të masave dhe ekzekutimin e dënimeve alternative, trajtimin e individualizuar të nevojave dhe aftësive të personit të mbikëqyrur për riintegrimin e tij në jetën shoqërore.

Këto objektiva do të realizohen nëpërmjet bashkëpunimit efektiv me organet e sistemit të drejtësisë penale, shërbimet sociale si dhe nëpërmjet forcimit të lidhjeve mes punonjësit të shërbimit të provës dhe të mbikqyrurit, për të siguruar zbatimin e misionit të shërbimit të provës.

Relatori i projektligjit, Z.Xhemal Qefalia u shpreh parimisht dakort me projektligjin duke vënë edhe njëherë theksin tek rëndësia e tij dhe objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet tij të cilat janë si më poshtë:

- Reduktimi i recidivizmit dhe garantimi i promovimit dhe integritetit social të personave të mbikëqyrur në shoqëri.
- Rritja e sigurisë në komunitet, duke ulur rrezikshmërisë e shkaktimeve të dëmit ndaj publikut të gjerë.
- Administrimi i drejtë i drejtësisë.
- Harmonizimi dhe unifikimi me parashikimet ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. (ligji nr. 37/2017)
- Reduktimi i kostove sociale të dënimeve penale.
- Rritja e partneritetit dhe bashkëpunimit me organizata të tjera publike ose private dhe me komunitetet vendore për të promovuar përfshirjen sociale të dënuarve/personave në shërbim prove.

- Forcimi i mbikëqyrjes së ekzekutimit të masave dhe ekzekutimit të dënimeve alternative.
- Trajtimi i individualizuar i nevojave dhe aftësive të personit të mbikëqyrtur për ri-integrimin e tyre në jetën shoqërore.
- Përcaktimi i qartë dhe konkret i detyrimeve për punonjësit e institucionit të Shërbimit të Provës, në përputhje me standardet që përcaktohen në Rekomandimet e Këshillit të Evropës.
- Rritja e numrit të dhënies së dënimeve alternative nga gjykata dhe shmangies nga burgimi.

Anëtarët e Komisionit të Sigurisë u shprehën dakort në parim me projektligjin dhe vijuan diskutimet dhe pyetjet në çështjet që lidhen me risitë e projektligjit; bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese, trajnimet apo kurset profesionale për punonjësit e shërbimit të provës, infrastruktura e mjediseve ku ushtron veprimtarinë shërbimi i provës etj.

Gjithashtu, gjatë diskutimit nën për nën anëtarët e komisionit u ndalën në çështje më konkrete në funksion të përmirësimit të këtyre dispozitave.

- ***Riformulime nën për nën***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare bazuar në çështjet e parashtruara si dhe nga diskutimi nën për nën i projektligjit, i sugjeron Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si komision përgjegjës, sugjerimet si më poshtë:

- **Në nenin 9 të projektligjit.** sugjerojmë të vihen kritere edhe për drejtorin e përgjithshëm të shërbimit të provës me qëllim unifikimin e tij me nenin 10 dhe 11 të projektligjit.
- **Neni 10 i projektligjit,** sugjerojmë të hiqen specifikimet të cilat janë të përcaktuara në ligjin për shërbimin civil dhe neni të riformulohet si më poshtë:

Neni 10

Drejtori i degës territoriale

1. Drejtori i degës territoriale është përgjegjës për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e përmbushjes së detyrave nga punonjësit e degës territoriale të Shërbimit të Provës.

2. Drejtori i degës territoriale duhet të zotërojë të paktën diplomë të nivelit “Master shkencor” / “Master i arteve” / “Master profesional”, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët psikologji, drejtësi, punë sociale ose sociologji.

- **Në neni 24 të projektligjit,** dukeqënë së rregullat e Konventës Evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht apo rregullat e

përcaktuara në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga shteti shqiptar, sugjerojmë të riformulohet si më poshtë:

Neni 24

Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë

1. Shërbimi i Provës në zbatim të rregulla të Konventës Evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht apo rregullat e përcaktuara në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara, bashkëpunon me Ministrinë e Drejtësisë për zbatimin e alternativës së dënimit me burgim.
2. Procedurat e bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

- **Në nenin 27 të projektligjit**, sugjerojmë të vendoset një afat brenda të cilit ministria përgjegjëse duhet të nxjerri aktet nënligjore dhe të riformulohet si më poshtë:

Neni 27

Akte nënligjore

Ngarkohet Ministri i Drejtësisë që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, pika 2, 14, pika 3, 15, pika 4, 17, pika 5, e 24, pika 2 të këtij ligji.

• Përfundim

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë duke vlerësuar se:

- **Në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
- **Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Relator

Kryetar

Xhemal QEFALIA

Ermonela (Felaj) VALIKAJ